

Çfarë duhet të dinë njujorkezët rreth vaksinave të COVID-19

Vaksinat shpëtojnë jetë. Kur vaksinoheni, ju ndihmoni në mbrojtjen tuaj nga COVID-19 dhe në krijimin e një komuniteti më të sigurt. Qyteti i Nju Jorkut (NYC) është përkushtuar që t'i mbajë të gjithë personat të sigurt dhe të shëndetshëm. Kjo përfshin edhe garantimin e aksesit të drejtë dhe të barabartë të vaksinës dhe dhënien e informacionit të nevojshëm, në mënyrë që njerëzit të marrin vendime pasi të jenë informuar rreth vaksinimit.

A funksionojnë vaksinat?

- Vaksinat e COVID-19 që janë autorizuar për përdorim emergjent nga Administrata e Ushqimit dhe Barnave (Food and Drug Administration, FDA) kanë treguar se janë shumë efektive në mbrojtjen e personave nga efektet e rënda të sëmundjes së COVID-19, shtrimi në spital dhe vdekja.

A janë të sigurt vaksinat?

- **Po. Nuk mund të infektoheni me COVID-19 nga vaksinat.** Vaksinat nuk përmbajnë virusin që shkakton COVID-19. Vaksinat e mësojnë sistemin imunitar të trupit se si të luftojë virusin, në mënyrë që të dijë si të veprojë nëse ekspozoheni ndaj COVID-19.
- Vaksinat kanë kaluar në shumë studime klinike që kanë përfshirë dhjetëra mijëra persona të moshave, racave dhe etnive të ndryshme. Provat e këtyre studimeve janë shqyrtuar me imtësi nga FDA dhe nga organizata të pavarura.

Si u zhvilluan kaq shpejt vaksinat?

- Zhvillimi i vaksinës së COVID-19 përfshiu burime të paprecedente. U shpenzuan miliarda dollarë dhe shkencëtarë nga e gjithë bota punuan pa pushuar.
- Shkencëtarët përdorën njohuri nga dekada të tëra kërkimesh për vaksina të tjera, duke përfshirë kërkime për vaksina për koronaviruset të tjera.

A ka efekte anësore nga vaksinat?

- Po, shumica e njerëzve përjetojnë disa efekte anësore. Efektet anësore të zakonshme janë dhimbja e krahut në vendin e vaksinës, dhimbje koke, dhimbje trupi, lodhje dhe temperaturë.
- Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim, telefononi në numrin **311** ose flisni me ofruesin e kujdesit shëndetësor.
- Efektet anësore mund të jenë të papëlqyeshme, por zakonisht, ato nuk përbëjnë shqetësim për shëndetin dhe largohen brenda 24 deri në 48 orësh. Përkundër kësaj, COVID-19 është një shqetësim i madh shëndetësor dhe mund të sjellë komplikime shëndetësore afatgjata, shtrim në spital dhe vdekje.



Kush mund të vaksinohet dhe sa do të kushtojë?

- Të gjithë njujorkezët nga mosha 16 vjeç e lart kualifikohen për t'u vaksinuar. Personat që jetojnë jashtë shtetit, por që punojnë ose studiojnë në Nju Jork kualifikohen gjithashtu për t'u vaksinuar. Te personat që kualifikohen në bazë të punës, përfshihen punëtorë me pagesë dhe pa pagesë. Për më shumë informacion, vizitoni faqen nyc.gov/covidvaccine. Për një listë të të gjitha grupeve që kualifikohen, vizitoni faqen nyc.gov/covidvaccinedistribution.
- Vaksinat jepen pa pagesë. Nëse keni sigurime, ata mund të faturohen, por ju nuk do të faturoheni për tarifën e përbashkët ose për ndonjë tarifë tjetër.
- Nuk është nevoja që të tregoni statusin e imigrimit që të vaksinoheni. Vaksinimi nuk do t'ju bëjë "barrë për popullin" ose të ndikojë në statusin tuaj të imigrimit.

A më mbrohet konfidencialiteti?

- Kur të merrni vaksinën, privatësia juaj do të mbrohet. Ekzistojnë ligje të rrepta që garantojnë konfidencialitetin e informacionit tuaj personal.

Ku mund ta bëj vaksinën?

- Pyesni ofruesin e kujdesit shëndetësor për të mësuar nëse ofron vaksinim.
- Vizitoni faqen nyc.gov/vaccinefinder për të gjetur një qendër vaksinimi dhe për të lënë një takim. Mund të telefononi gjithashtu në numrin 877-829-4692 për të lënë një takim në qendrat që administrohen nga NYC.

A duhet ta marr vaksinën nëse e kam kaluar më parë COVID-19?

- Po, meqenëse ekziston mundësia që të infektoheni sërish me COVID-19, duhet të vaksinoheni. Vaksinat janë të sigurta dhe mund të rrisin mbrojtjen që ka krijuar tashmë trupi juaj.

Kur të vaksinohem, a mund ta eliminoj distancimin fizik dhe të mos mbaj më maskë në fytyrë?

- Jo. Duhet të jemi të kujdesshëm derisa të vaksinohen më shumë persona dhe derisa të kalojë më shumë kohë, që ne të kuptojmë më mirë ndikimin e vaksinave në përhapjen e COVID-19. Të gjithë personat duhet të vazhdojnë të zbatojnë masat kryesore parandaluese, edhe pas vaksinimit:
 - Qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë.
 - Ruani një distancë prej të paktën 6 këmbë nga personat e tjerë.
 - Mbani maskë në fytyrë (të puthitur mbi gojë dhe hundë) kur të dilni nga shtëpia.
 - Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose përdorni një dezinfektues duarsh me bazë alkooli.

Është e kuptueshme që disa persona mund të mos jenë të sigurt rreth vaksinimit ose të kenë pyetje të tjera. Për të mësuar më shumë, bisedoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor, telefononi në numrin **311** ose vizitoni nyc.gov/covidvaccine.

